



Fazli Veliu
Pronar
"Radio Vizioni"
Nr. Biz: 80478437
Radio Vizioni
R081
Podujevë

VENDIMI: LIC/KPM-2013/26
Ref: 1306/747/LIC/II

VENDIM

lidhur me ndryshimin e vendndodhjes së sistemit të transmetimit të Radio Vizioni, Podujevë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Vizioni është subjekt transmetues me mbulim lokal, i cili më datën 16 prill 2010 është i pajisur me licencë afatgjate të KPM-së, për të transmetuar radio programe në komunën e Podujevës .
3. Më datën 1 prill 2013, pronari i Radio Vizioni përmes raportit financiarë, e ka njoftuar KPM-në se ka bërë ndryshimin e vendndodhjes së sistemit të transmetimit, brenda qytetit të Podujevës. Arsyeja është se, lokacioni i ri është në pronësi të pronarit të Radio Vizionit dhe në aspektin financiarë është më i favorshëm për të ushtruar veprimtarinë.
4. Më 22 mars 2013, Departamenti i Menaxhimit Frekuencor (DMF), i Zyrës Ekzekutive të KPM-së ka bërë matjet teknike për të vlerësuar parametrat teknik dhe mundësitë për kalim të transmetimit të Radio Vizioni në pikën e propozuar për transmetim.

Arsyetimi

5. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur për Media, përcakton se, KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.


6. Rezultatet e matjeve të bëra nga DMF tregojnë se ndryshimi i vendndodhjes së sistemit të transmetimit të Radio Vizioni me transemtim nga pika transmetuese e propozuar mund të bëhet, dhe nuk ndikon fare në ndryshimin e zonës së mbulimit, duke mos shkaktuar ndryshime në Tabelën Teknike të Licencës së KPM-së.
7. Neni 6.1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së thekson se: *“përveç dispozitave për transferimin e pronësisë të specifikuar në Nenin 5.0, i Licencuari mund të bëjë kërkesë për ndryshimet e specifikuara në paragrafet e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Përhapjes Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit, duke ia bërë me shkrim kërkesën për këto ndryshime KPM-së. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm me miratim paraprak me shkrim nga ana e KPM-së”*.
8. Prandaj, në pajtim me nenin 21, paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së dhe 6.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, KPM konstaton se, kërkesa e palës për ndryshim të vendndodhjes së sistemit të transmetimit brenda qytetit të Podujevës i përmbush standardet e KPM-së për këto ndryshime të licencës së KPM-së.
9. Arsyetimin për ndryshim të vendndodhjes së sistemit të transmetimit, KPM e pranon si të mjaftueshëm dhe në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
10. Me rastin e ndryshimit të vendndodhjes së sistemit të transmetimit, Radio Vizioni nuk e ndryshon kategorinë e subjektit transmetues, pra mbetet subjekt transmetues me mbulim lokal.

Vendim

11. Komisionin vendosë që Radio Vizionit t'i lejohet ndryshimi i vendndodhjes së sistemit të transmetimit, sipas koordinatave të përcaktuara nga DMF.

Lëshimi i Vendimit

12. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur për Media dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit.


Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



6 gushtor 2013
datë